



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, STREHIMIT DHE SHËNDETIT PUBLIK

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al

Nr.400/1Prot.

Shkodër, më 21.01.2019

Lënda: Jepet informacioni i kërkuar

Rruga: _____

Në vijim të kërkesës suaj Nr. 739, datë 08. 01. 2019, regjistruar në Bashkinë Shkodër me nr. 400, datë 10. 01. 2019, në të cilën, bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit, ju informojmë si më poshtë:

Bashkia e Shkodrës, gjatë vitit 2016, ka filluar procesin e krijimit dhe vënies në funksion të qendrave komunitare “Për Familjen”; nga një në çdo lagje të qytetit dhe gjithashtu në njësitë administrative të Bashkisë së Shkodrës, me synim shtrirjen e shërbimit komunitar në territorin e bashkisë së Shkodrës.

Në secilën prej këtyre qendrave, ofrohen shërbime si: pritje, informim, orientim, këshillim psikologjik, këshillim juridik, referim dhe çdo shërbim tjetër specifik, sipas nevojave të rastit.

Sa i përket Buxhetit të planifikuar për qendrat komunitare, në faqen web të Bashkisë së Shkodrës, është i publikuar buxheti i miratuar i Bashkisë së Shkodrës. Në këtë dokument për vitet 2016-2018 në programin buxhetor P10: “Strehimi dhe Shërbimet Sociale” gjeni informacion mbi buxhetin vjetor të planifikuar për qendrat komunitare <https://docs.google.com/viewer?url=http://buxheti.info/shkoder/MediaUploader/2018215114236.pdf>.

Ndërsa për vitin 2019 ky informacion gjendet në programin nr. 104 “Familja dhe Fëmijët”. <https://docs.google.com/viewer?url=http://buxheti.info/shkoder/MediaUploader/20190115104511.pdf>.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.

KRYETAR

Voltana Ademi
